



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:019360

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004240

KPPP.nr.106/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “TEB” SH.A., me seli në Graçanicë, Magjistratja Prishtinë – Ferizaj km7, kundër debitorëve 1. “Moenja” SH.P.K., me NUI: 811563586, me seli në Prizren, rruga “Besim Shala”; 2. K.H., me vendbanim në Prizren, fshati Shajnë Dragash; 3. B.H., me vendbanim në Prishtinë, Ulpianë C13 nr.12; 4. A.G., me vendbanim në Skenderaj, fshati Llaushë, që të gjithë përfaqësuar sipas autorizimit nga Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi, që të dy avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.864/23 të datës 27.12.2023, të Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorëve 1. “Moenja” SH.P.K., 2. K.H., 3. B.H., 4. A.G., i paraqitur kundër urdhrit përmbarimor P.nr.864/23 të datës 27.12.2023, të Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbarimor P.nr.864/23 i datës 27.12.2023, i Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha.

A r s y e t i m

Përmbaresit Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.864/23 të datës 27.12.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarimore - Marrëveshja mbi kredinë Nr.88714 të datës 03.12.2021 Shtojca 1) Marrëveshja mbi Pengun, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20211206-355 i datës 06.12.2021; Marrëveshja mbi kredinë Nr.94166 të datës 18.10.2022 Shtojca 1) Marrëveshja mbi Pengun, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20221019-52 i datës 19.10.2022, duke detyruar debitorët nga dita e dorëzimit të urdhrit t'ia paguaj kreditorit shumën prej 90,706.65 €, ashtu që përmbarimi të realizohet me bllokimin e llogarive bankare të debitorëve dhe bartjen e mjeteve në llogarinë e kreditorit, me sekuestrimin e kolateralit të lënë peng sipas marrëveshjeve mbi pengun.

Debitorët në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk i përmbushin elementet sipas dispozitave të LPP-së, pasi që të njëjtat janë bashkangjitur në kopje. Tutje ka shtuar se kontrata mbi pengun nuk është përpiluar në harmoni me Ligjin nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, pasi që kreditori në listat e pengut nuk e ka specifikuar secilin peng veç e veç, vlerën e secilit peng si dhe shumën totale të pengut, gjithashtu shuma e kërkuar nga debitori prej 90,706.65 €, duke mos e precizuar borxhin e paguar nga debitori rreth 16,000.00 €, e që rezulton se borxhi i mbetur është 84,000.00 € e jo vlera të cilën e pretendon kreditori, pra kërkesa e kreditorit është e kundërligjshme pasi që siç shihet është aplikuar kamata mbi kamatë. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorëve, të anulohet urdhri përmbarimor si dhe të detyrohet kreditori që debitorëve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës sipas TOAK në shumën prej 780.00 €.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorëve, ku ndër të tjerash ka deklaruar se dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor i plotësojnë të gjitha kushtet sipas LPP-së. Tutje ka shtuar se debitorët në prapësim kanë pretenduar se kreditori ka llogaritur kamat mbi kamatë, mirëpo një pretendim i tillë nuk qëndron për faktin se interesi i rregullt nuk llogaritet kamatë, aplikimi i interesit të rregullt dhe kamatëvonesës nuk mund të konsiderohet si kamat mbi kamatë. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorëve është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente përmbartuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentet përmbartuese përkatësisht - Marrëveshja mbi kredinë Nr.88714 të datës 03.12.2021 Shtojca 1) Marrëveshja mbi Pengun, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20211206-355 i datës 06.12.2021; Marrëveshja mbi kredinë Nr.94166 të datës 18.10.2022 Shtojca 1) Marrëveshja mbi Pengun, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20221019-52 i datës 19.10.2022, të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, nenit 27 të LPP-së dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, për tu paraqitur si dokument përmbartues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, Marrëveshja mbi Pengun Nr.88714 e datës 03.12.2021, është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengun R-20211206-355 të datës 06.12.2021; Marrëveshja mbi Pengun Nr.94166 e datës 18.10.2022, është

regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengun R-20221019-52 të datës 19.10.2022, si dhe të njëjtat janë paraqitur në kopje të vërtetuara, ndërsa Konfirmimi mbi regjistrimin e pengut është lëshuar konform nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-136 Për Regjistrimin e Pengut në Regjistër Për Sendet e Luajtshme.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorëve, se në rastin konkret kanë paguar një pjesë të borxhit përkatësisht shumën prej 16,000.00 €, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se debitorët nuk kanë dorëzuar asnjë dëshmi përmes së cilës do të mund të vërtetohej një fakt i tillë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.106/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.